

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6654
E premte, 15 korrik 2022
çmimi 0.40 €

Europol-i: Terrorizmi mbetet kërcënim për BE-në | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS TË ENJTEN KA MBAJTUR SEANCË PLENARE | FAQE 4-5

KUVENDI VOTON NË PARIM BYRONË PËR KONFISKIMIN E PASURISË



Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Projektligji, pas një debati në mes të pozitës dhe opozitës, ka marrë 58

vota për nga 61 veta sa kanë votuar. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ndryshe nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, nuk ka votuar për, por ka abstenuar

OPINION

NJË VËSHTRIM MBI DRAFTIN E DOKUMENTIT TË STRATEGJISË SË ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2022-2031 | F. 8-9-10

Shkruan: Dr. sc. Ferat SHALA



AKTUALE



SHBA-ja DHE IZRAELI ZOTOHEN TA NDALOJNË IRANIN QË TË MARRË BOMBË BËRTHAMORE | F. 2

DEPUTETJA E LV-së KËRKON NGA KUVENDI DHE QEVERIA TË MARRIN MASA NDAJ MEDIEVE | F. 6

EKONOMI



LULZIM RAFUNA, KRYETAR I RI I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS | F. 7

SPORT




KOK-U SHPËRBLEN ME 13 500 EURO MEDALISTËT E LOJËRAVE MESHDETARE 'ORAN 2022' | F. 12



RRETH 900 TË INFEKTUAR BRENDA DITËS NGA KORONAVIRUSI NË KOSOVË

| FAQE 3



INSPEKTORATI GJOBITË TETË FURRA NË PEJË DHE GJILAN, MASHTRUAN PËR PESHËN E BUKËS

| FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

ShBA-ja dhe Izraeli zotohen ta ndalojnë Iranin që të marrë bombë bërthamore

WASHINGTON, 14 KORRIK - Presidenti amerikan Joe Biden tha të enjten se Shtetet e Bashkuara "nuk do të presin përgjithmonë" që Irani t'i bashkohet marrëveshjes bërthamore, një ditë pasi tha se do të ishte i gatshëm ta përdorte forcën kundër Teheranit si mjetin e fundit nëse do të ishte e nevojshme.

Në një konferencë shtypi me kryeministrin izraelit Yair Lapid, pas bisedimeve me dyer të mbyllura rreth programit bërthamor të Iranit, Bideni tha se ShBA-ja i kishte përgatitur udhëheqjes iraniane një rrugë për t'u rikthyer në marrëveshjen bërthamore dhe ishte ende duke pritur një përgjigje. "Kur do të vijë kjo, nuk jam i sigurt", tha Bideni, "por ne nuk do të presim përgjithmonë", shtoi ai. "Ne nuk do të lejojmë Iranin të marrë armë bërthamore", tha Bideni në një konferencë shtypi më 14 korrik pas nënshkrimit të

përbashkët të Deklaratës së Jerusalemit gjatë udhëtimit të parë të presidentit të ShBA-së në Lindjen e Mesme që nga marrja e detyrës në janar të vitit 2021. Deklarata ripohoi gjithashtu mbështetjen e Uashingtonit për avantazhin ushtarak rajonal të Izraelit dhe aftësinë e tij "për ta mbrojtur vetveten". "Shtetet e Bashkuara theksojnë se një pjesë integrale e këtij zotimi është angazhimi për të mos lejuar kurrë që Irani të marrë një armë bërthamore dhe se jemi të përgatitur të përdorim të gjithë elementët e fuqisë kombëtare për të siguruar që kjo nuk do të ndodhë", shkruhet në deklaratë. Lapid tha pas nënshkrimit se "e vetmja mënyrë për të ndaluar një Iran bërthamor është nëse Irani e di se bota e lirë do ta përdorë forcën".

Bideni ka thënë se dëshiron t'i kthejë Shtetet e Bashkuara në marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 që Irani nënshkroi me



fuqitë botërore, ndërsa ai ishte zëvendës-president nën administratën e Barack Obamës.

Por presidenti Donald Trump u tërhoq nga marrëveshja në vitin 2018, duke thënë se Irani nuk po i përmbushte kushtet e marrëveshjes dhe se po financonte terrorizmin në Lindjen e Mesme, një

pretendim që Teherani e ka mohuar.

Duke folur për një televizion izraelit, Bideni tha se marrëveshja përfaqëson mundësinë më të mirë për t'i bllokuar përpjekjet e Iranit për të zhvilluar një bombë bërthamore. "E vetmja gjë më e keqe se Irani që ekziston tani është një Iran me armë

bërthamore dhe nëse mund t'i kthehem marrëveshjes, mund t'i mbajmë ato nën kontroll", tha ai.

Kur u pyet nëse Shtetet e Bashkuara mund ta përdorin forcën nëse është e nevojshme, ai u përgjigj: "Nëse të ishte zgjidhja e fundit, po".

Ata që e kundërshtojnë marrëveshjen kanë thënë se lehtësimi i sanksioneve do t'i sigurojë Teheranit para shtesë për t'i mbështetur forcat e tij përfaqësuese në Liban, Siri, Jemen dhe Irak.

Bideni, gjithashtu, ka të ngjarë të përballtet me kundërshtimin e vazhdueshëm nga Arabia Saudite kur të udhëtojë në vendin e Gjirit Persik më vonë gjatë javës. Arabia Saudite, e udhëhequr nga myslimanët sunitë, është gjithashtu një rivale e ashpër e Iranit me shumicë shiite, ku të dy konkurrojnë për ndikim në rajon.

Komisioni Evropian i jep Gjeorgjisë më shumë kohë për përmbushjen e prioriteteve të BE-së

BRUKSEL, 14 KORRIK - Komisioni Evropian do ta shtyjë vlerësimin e ardhshëm të përparimit të Gjeorgjisë drejt përmbushjes së prioriteteve të kërkuara përpara se të konsiderohet anëtarësimi në BE, duke i dhënë vendit më shumë kohë për t'i përmbushur ato.

Michael Rupp, një përfaqësues i Drejtorisë së Zgjerimit të Komisionit Evropian, më 13 korrik tha se shtyrja kishte për qëllim t'i jepte Gjeorgjisë "kohën e duhur për të punuar me kujdes" për përmbushjen e prioriteteve për ta fituar statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian.

Komisioni tani do ta vlerësojë zbatimin e hapave të kërkuar nga Gjeorgjia diku në vitin 2023 dhe



jo në dhjetor të këtij viti, siç ishte menduar fillimisht.

Rupp tha se Komisioni ka qenë

"shumë i interesuar" për ta parë Gjeorgjinë të punojë "fort, thellë dhe tërësisht" mbi prioritetet. Ai

tha se zyrtarët e BE-së nuk donin të "nxitonin" Gjeorgjinë duke pasur parasysh mosmarrëveshjet politike në vendin e Kaukazit Jugor mbi mënyrat për ta zbatuar programin 12-pikësh të Brukselit.

Shtyrja "do t'i japë sistemit politik të Gjeorgjisë kohën e duhur për të punuar me kujdes mbi këto prioritetet", tha ai.

Gjeorgjia është kapluar nga trazira me muaj, me dhjetëra mijëra njerëz që dolën në rrugët e Tbilisit për të protestuar ndaj asaj që opozita e sheh si dështim të qeverisë për të bërë përparim në reformat e kërkuara.

Protestuesit kanë kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Irakli Garibashvili dhe formimin e një

qeverie të re të "pajtimt kombëtar".

Garibashvili ka thënë se qeveria e tij është "mobilizuar" për t'i përmbushur kërkesat e vendosura nga Brukseli "në mënyrë që ta marrim statusin e kandidatit sa më shpejt të jetë e mundur".

Komisioni Evropian tha se kushtet që Gjeorgjia duhet të përmbushë përfshijnë përfundimin e polarizimit politik, përparimin në lirinë e medias, gjyqësorin dhe reformat zgjedhore.

Sondazhet e opinionit tregojnë se të paktën 80 për qind e popullsisë gjeorgjiane favorizojnë planet për t'u bashkuar me BE-në, si dhe në NATO.

Macroni: Franca duhet të mobilizohet për mungesën e mundshme të energjisë

PARIS, 14 KORRIK - Franca duhet të mobilizohet për t'u përgatitur për skenarin e mundshëm që do të ketë mungesë energjie këtë vjeshtë, sepse Rusia po përdor shkurtimet në furnizimet në Evropë si një armë në luftën e saj me Ukrainën, tha të enjten presidenti francez Emmanuel Macron.

Duke folur në një intervistë televizive për ta shënuar ditën kombëtare të Francës, Macron tha se një pjesë e këtij mobilizimi do t'i përfshinte

konsumatorët dhe bizneset franceze që ta pakësojnë përdorimin e tyre të energjisë. Bashkimi Evropian, i cili, përpara se të niste lufta në Ukrainë, ka marrë rreth 40 % të gazit nga Rusia, ka bërë plane për t'i zvogëluar importet për dy të tretat deri në fund të vitit dhe për ta ndaluar plotësisht gazin rus deri në vitin 2027.

Blloku ka vendosur tashmë që ta bllokojë qymyrin rus, duke filluar nga gushti, dhe shumicën e naftës ruse brenda gjashtë muajsh.

Qëllimi është që Rusisë t'i zvogëlohet shuma prej 850 milionë dollarësh në ditë, që merr nga shijtjet e naftës dhe gazit në Evropë.

Zvogëlimi i kësaj shume pastaj do ta pengonte financimin e luftës së saj në Ukrainë. Qeveritë dhe ndërmarrjet evropiane kanë blerë gaz të lëngshëm natyror nga Shtetet e Bashkuara. Ky gaz, që shpërndahet me anije, është më i shtrenjtë në krahasim me gazin që sigurohet nga Rusia përmes tubacioneve.



Rreth 900 të infektuar brenda ditës nga koronavirusi në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - 871 raste të reja me koronavirus janë raportuar të mërkurën në Kosovë nga Ministria e Shëndetësisë (MSh). MSh njoftoi se, pas 2 376 mostrave të testuara gjatë 24 orëve, 36.65 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Aktualisht janë 3 263 raste aktive me koronavirus në Kosovë.

Të mërkurën një person ka vdekur nga Covid-19.

Numri i rasteve me koronavirus në Kosovë ka nisur të rritet në gjysmën e dytë të qershorit. Muajt e pranverës kanë qenë kryesisht të qetë sa i përket infektimit - ka pasur ditë me zero raste. Shkalla e infeksionit është në rritje edhe në vende të tjera të Ballkanit dhe më gjerë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka dalë sërish me mesazh për respektim të masave kundër Covidit.

Sipas IKShPK-së, Kosova po vazhdon të shënojë shtim të

rasteve të reja të Covid-19 me tendencë të rritjes në ditët në vijim. "Fatmirësisht sot nuk është raportuar asnjë rast i të vdekurit nga kjo sëmundje. Në vende të ndryshme të botës po regjistrohen raste të shumta me Covid-19, sepse pandemia Covid-19 nuk ka mbaruar. IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik, andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes, rekomandohen të testohen", ka njoftuar IKShPK-ja.

Sipas këtij instituti, me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen të vaksinohen, me dozën e parë, të dytë dhe të tretë mund të vaksinohen të gjithë personat e moshës mbi 12 vjeç; me dozën e katërt mund të vaksinohen personat e



moshës mbi 60 vjeç, me kusht që të kenë kaluar katër muaj nga marrja e dozës së tretë. "MSh dhe IKShPK

rekomandojnë qytetarët që, përkundër situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm në

zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjithëse dhe të vaksinohen kundër Covid-19", ka njoftuar IKShPK-ja.

Nisin konsultimet për qeverinë e re, Vuçiqi takon Shaip Kamberin



PRISHTINË, 14 KORRIK - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka nisur konsultimet për mandatin e qeverisë së re me një takim me kryetarin e Partisë për Veprim Demokratik, Shaip Kamberi, i cili është përfaqësues i Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës.

Ky koalicion do të ketë një mandat në Kuvendin e Serbisë. Kamberi ka thënë se kërkon integrimin e shqiptarëve dhe se pjesëmarrja në Qeverinë e Serbisë nuk është prioritet i tyre. "Zbatim të marrëveshjeve për Luginën, ndryshim të ligjeve për pakicat dhe fond për zhvillim", ishin kërkesat që ia dorëzuan presidentit Vuçiq, ka shkruar Kamberi në "Facebook".

Ai ka thënë se prioritet i koalicionit është integrimi në institucionet publike, ato në nivel lokal dhe regional, ndalimi i pasivizimit të adresave, fondi

zhvillimor për Luginën dhe ndryshimi i Ligjit për Flamurin. Në prononcimet e mëparshme për medie, Kamberi ka thënë se në bisedë do të insistojë në zbatimin e "Planit shtatëpikësh" që u miratua nga Qeveria e Serbisë në vitin 2013 dhe ku përmenden probleme të shumta me të cilat përballet pakica kombëtare shqiptare në Serbi, si integrimi ekonomik i shqiptarëve, njohja e diplomave, mospërdorimi i shprehjeve fyese ndaj tyre.

Pas largimit nga Presidenca e Serbisë, Kamberi u tha gazetarëve se shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë ende nuk janë integruar as në nivel lokal të institucioneve shtetërore e as në rajon. "Kërkesa jonë është që integrimet të fillojnë nga fundi dhe jo nga maja e qeverisë", ka thënë Kamberi.

Gjykata Speciale nga 25 korriku shkon në pushim veror

PRISHTINË, 14 KORRIK - Gjykatësit, prokurorët dhe stafi përcjellës i Gjykatës Speciale në Hagë nga 25 korriku do të hyjnë në pushim veror. Duke filluar nga 25 korriku deri më 12 shtator do të vazhdojë pushimi veror i tyre, për rreth dy muaj ata nuk do të merren me çështje juridike.

Gjykata Speciale deri tani ka dënuar me nga katër vjet e gjysmë burgim drejtuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn. Ata janë shpallur fajtorë për pengim të administrimit të drejtësisë. Në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020 vazhdojnë të

mbahen edhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, si dhe eprori i UÇK-së, Salih Mustafa. Specialja do ta nisë punën më 13 shtator, ku për katër ditë radhazi prokurori kundër Salih Mustafës do t'i bëjë deklaratat përmbyllëse.





KUVENDI I KOSOVËS TË ENJTEN KA MBAJTUR SEANCË PLENARE

Kuvendi voton në parim Byronë për Konfiskimin e Pasurisë

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Projektligji, pas një debati në mes të pozitës dhe opozitës, ka marrë 58 vota për nga 61 veta sa kanë votuar. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ndryshe nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, nuk ka votuar për, por ka abstenuar

njëta”, duke shtuar se byroja dhe vetingu nuk janë e njëjta gjë. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se në lexim të dytë do të adresohen edhe rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia e tij nuk e mbështet qeverinë nëse nuk ka gjithëpërfshirje. “Ju keni kërkuar gjithëpërfshirje, edhe ne po

kërkojmë gjithëpërfshirje... Ju, kryetar i Kuvendit, keni marrë përsipër dërgimin e këtij ligji në Komisionin e Venecias dhe këtë ndërmarrjen tuaj e kemi vlerësuar këtu në Kuvend”, ka thënë ai, duke shtuar se “jam vullnetar për verifikimin e pasurisë, vërejtjet janë për ta mbrojtur rendin kushtetues dhe për ta bërë reformën përmjend”. Shefi i grupit parlamentar i

Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se për reformën në drejtësi është i rëndësishëm konsensusi politik. “Konsensusin për reformën në drejtësi e shoh jashtëzakonisht të rëndësishëm. Mendoj që këtu edhe qeveria duhet të reflektojë”, ka thënë Tahiri.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se janë pajtuar

bindur se komisioni funksional do t'i fusë rekomandimet e Venecias. E ka aftësinë t'i përfshijë ato opinione”, ka thënë ai.

Me këtë projektligj parashihet që të gjithë zyrtarët publikë në Kosovë mund të jenë subjekt i verifikimit të pasurisë nëse ekzistojnë dyshime se ajo është fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Përveç tyre, verifikimi dhe konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme do të bëhet edhe për anëtarët e familjes së tyre dhe palëve të treta, që nënkupton personat te të cilët dyshohet se është bartur pasuria e zyrtarëve publikë.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se është e rëndësishme që të takohen si subjekte politike. “Është e domosdoshme që të kemi sa më shumë konsultime edhe si subjekte politike. Përveç kësaj, duhet ta bëjmë ndarjen e qartë të gjërave që nuk janë të

Krasniqi: Kuvendi i Kosovës bëri një gabim të madh

Njohësi i proceseve politike, Albert Krasniqi, ka reaguar pas miratimit të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ai ka thënë se as nuk mund të mendohet në një demokraci, që Kuvendi me vetëdije të miratojë një projektligj që nuk garanton të drejtat themelore të njeriut; që nuk respekton standardet ndërkombëtare; dhe që është në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. “Për Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme tashmë ka

një vlerësim të tillë nga mekanizmat më kredibilë ndërkombëtarë, të cilat nuk i kontestoi askush nga brenda. Të vetmin argument që qeveria kishte, ishin numrat që kontrollonte në Kuvend. Nga aspekti procedural është shumë më vështirë që Kuvendi të adresojë vërejtje për pothuajse secilin nen të këtij projektligji. Çdo ndryshim duhet të bëhet në formë të votimit të amendamenteve në seancë. Nuk është parim që Kuvendi të ndryshojë kaq shumë një projektligj të cilin nuk e ka iniciuar vetë”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Ai ka thënë se ky projektligj duhet të kthehet në qeveri. “Një grup gjithëpërfshirës duhet t'i adresojë të gjitha vërejtjet e Komisionit të Venecias dhe grupeve të tjera të interesit. Drafti i dytë duhet t'i dërgohet sërish Komisionit të Venecias për vlerësim, dhe kështu të veprohet deri në adresimin e vërejtjes së fundit. Kështu ka bërë Bullgaria kur ka krijuar një mekanizëm të tillë. Për të korrigjuar këtë gabim ende ka kohë. Qeveria mund dhe duhet ta tërheqë këtë projektligj para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë”, ka deklaruar Krasniqi.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 KORRIK - Në Kuvendin e Kosovës është votuar në lexim të parë Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Ky projektligj ka kaluar vetëm me votat e pushtetit, 58 vota për dhe 3 abstenime dhe pa mbështetjen e opozitës. Ndër deputetët që ka abstenuar është edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Konjufca ka deklaruar paraprakisht se e ka ndër mend të abstenojë meqë do të presë derisa komisioni parlamentar t'i përfshijë në projektligj opinionet e Komisionit të Venedikut. “Pasi i kam lexuar opinionet e komisionit të Venedikut, kam konstatuar se më duket korrekte të pres përfshirjen e opinionëve të Komisionit të Venedikut në lexim të dytë meqenëse vetë e kam dërguar për opinion. Jam i

Europoli: Terrorizmi mbetet kërcënim për BE-në

BRUKSEL, 14 KORRIK - Intensiteti i sulmeve ka rënë, por terrorizmi mbetet kërcënim për Bashkimin Evropian për shkak të luftës në Ukrainë dhe rritjes së propagandës gjatë pandemisë së koronavirusit, vlerëson agjencia evropiane e policisë, Europol, në raportin e ri për sigurinë.

Numri i përgjithshëm i sulmeve të suksesshme, të penguar dhe të dështuaram ka qenë 15 në vitin 2021, që do të thotë dukshëm më pak se 57, sa kanë qenë në vitin paraprak, njofton Europol.

Sipas kësaj agjencie me seli në Hagë, kjo ka ndodhur për shkak të rënies së konsiderueshme të numrit të sulmeve që karakterizohen si terrorizëm i krahut të majtë. Megjithatë, pushtimi i Ukrainës nga Rusia dhe ndikimi i pandemisë Covid-19 paraqesin kërcënime për sigurinë në vitet në vazhdim, thuhet në raport. "Konstatimet e raportit konfirmojnë se

terrorizmi mbetet kërcënim real dhe i pranishëm në BE", tha në një deklaratë shefja e Europol-it, Catherine De Bolle. "Në një kohë të trazirave gjeopolitike, BE-ja duhet t'u përmbahet masave të saj kundër terrorizmit më shumë se kurrë. Nuk ka dyshim se ndryshimet gjeopolitike dhe pasojat e agresionit të Rusisë në Ukrainë do të kenë ndikim të gjatë në sigurinë e BE-së", shtoi De Bolle.

Sipas saj, lufta tashmë ka tërhequr disa individë të radikalizuar nga vendet anëtare, të cilët u janë bashkuar të dyja palëve ndërluftuese.

De Bolle tha se konflikti ka të ngjarë të shkaktojë reagime dhe nxitje të dhunshme ekstremiste, sidomos në internet. Ajo tha se vendet evropiane duhet të marrin mësim nga e kaluara, kur luftëtarët e huaj janë kthyer nga fushëbetejat në Lindjen e Mesme.

Sipas raportit të Europol-it,

pandemia Covid-19 i ka bërë veçanërisht të rinjtë dhe të miturit të cenueshëm ndaj radikalizimit për shkak të izolimit social dhe kohës së kaluar në internet.

Në vitin 2021 në BE janë arrestuar 388 persona të dyshuar për vepra penale që lidhen me terrorizmin. Më shumë se dy të tretat e arrestimeve - 260 - janë bërë pas hetimeve për shkelje të ligjeve që lidhen me terrorizmin xhihadist në Austri, Francë dhe Spanjë, thuhet në raportin e Europol-it.

Situata në Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2021 vetëm një incident i dhunshëm në Ballkanin Perëndimor, i lidhur potencialisht me xhihadizmin, është raportuar në Europol. Bëhet fjalë për një ngjarje që ka ndodhur më 19 prill të vitit 2021, kur një shtetas i Shqipërisë, 34

vjeç, është arrestuar nën akuzën për terrorizëm, pasi ka goditur me thikë pesë persona në një xhami në Tiranë.

Gjatë gjyqimit i dyshuari është cilësuar si i papërgjegjshëm dhe është dërguar në një spital psikiatrik. Sipas raportit të Europol-it, metodat e përdorura për radikalizëm pasqyrojnë skenarin kompleks politik në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku çështjet që lidhen me identitetin etnik dhe fetar, kombinohen me vështirësitë ekonomike dhe sociale.

Grupet e radikalizuara dhe ekstremiste në rajon zakonisht janë të vogla dhe të udhëhequra nga individë, që anëtarët e grupit i pranojnë si autoritete fetare.

Sipas vlerësimeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, grupet dhe individët selafistë, që mbrojnë një interpretim ultrakonservator dhe ekstremist të islamit, mbeten shtytësit kryesorë të radikalizimit në rajon,

thuhet në raportin e Europol-it. Brenda komuniteteve selafiste është vënë re se predikuesit aktivë në "xhamitë paralele" dhe tubimet joformale promovojnë dhunë, ndërsa të kthyerit nga Siria dhe zona të tjera të konfliktit kanë vazhduar të përhapnin ideologji xhihadiste. Sipas Europolit, disa vende të Ballkanit Perëndimor kanë konfirmuar trendin e viteve të kaluara, sipas të cilit, disa grupe ekstremiste e paraqesin veten si organizata joqeveritare që "punojnë për qëllime humanitare". Duke u vendosur në këtë pozitë, ato mbledhin donacione, të cilat më pas u kanalizohen përkrahësve ose simpatizantëve të ideologjive radikale.

Gjatë vitit 2021 disa të dyshuar janë kthyer nga zonat e konfliktit në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. (REL)



që pronësinë mbi vetingun ta marrë Kuvendi i Kosovës. "Nuk mund ta bëjë as vetingun e as këto ligje një parti", ka thënë Besnik Tahiri duke shtuar se nëse pozita hyn në këtë proces pa koordinim, atëherë ata nuk do ta mbështesin.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i cili e ka dërguar këtë projektligj në Komisionin e Venecias, ka deklaruar se i ka pritur opinionet e këtij komisioni dhe se i ka lexuar ato me vëmendje.

Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe

Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme përfshin periudhën nga data 17 shkurt 2008 dhe periudhën brenda dhjetë vjetësh nga momenti kur zyrtarët publikë pushojnë së ushtruar funksionin e tyre.

Projektligji thotë se Byroja udhëhiqet nga drejtori i përgjithshëm që votohet nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm. Votimi për zgjedhjen e drejtorit bëhet në mënyrë të fshehtë. Mandati i drejtorit është pesëvjeçar. Sipas projektligjit,

për fillimin e procedurës për verifikim vendos drejtori i byrosë, pastaj byroja vazhdon mbledhjen dhe hulumtimin e dokumentacionit relevant për rastin.

Në anën tjetër, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) kishte vlerësuar se qëllimi i projektligjit është legjitim, por në disa aspekte nuk e respekton Kushtetutën e Kosovës.

Jeton Hasani, hulumtues i lartë në këtë institut, kishte thënë se projektligji përmban të meta të caktuara në aspektin juridik, duke filluar nga zgjedhja e

drejtorit të përgjithshëm. Sipas tij, drejtori i kësaj byroje është autoriteti kryesor për fillimin e procedurave të verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë dhe zgjedhet me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi. Njëherësh, sipas tij, drejtori i kësaj byroje mund të shkarkohet lehtësisht.

Sipas ministres Haxhiu, në konstatimet e Komisionit të Venecias rekomandohet ndërmarrja e veprimeve për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe kushtetuese në mënyrë që të arrihet rezultati i synuar për një gjyqësor me integritet

profesional dhe efikas. "Komisioni rekomandon fillimisht verifikimin e niveleve të larta në gjyqësor dhe në prokurori përmes një mekanizimi të jashtëm, pra nivele të larta, duke filluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe kryetarët e të gjitha gjykatave dhe kryeprokurorëve të të gjitha prokurorive".

Kuvendi ka votuar në lexim të dytë edhe Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.

Deputetja e LV-së kërkon nga Kuvendi dhe qeveria të marrin masa ndaj medieve

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, gjatë fjalës së saj në Kuvendin e Kosovës ka bërë thirrje që Kuvendi dhe qeveria të marrin masa ndaj medieve në Kosovë. Pacolli ka deklaruar se në raportin e Parlamentit Evropian është thënë se "kohën e fundit janë vërejtur investime të mëdha private në medie". Sipas Pacollit, ky raport thotë se përmes investimeve të tilla private është rritur edhe mundësia e ndikimit në disa medime kryesore në vend dhe ato online.

Teksa ka përmendur si burim të fjalëve të saj këtë raport të Parlamentit Evropian, Pacolli ka kërkuar vëmendjen e Kuvendit dhe të qeverisë për të marrë

masa dhe për të kuptuar se çfarë po ndodh me funksionimin e medieve si dhe identifikimin e pronësisë së medieve në Kosovë. "Vitet e fundit janë vërejtur investime të mëdha private në medie përmes të cilave është krijuar mundësia e ndërhyrjes dhe ndikimit në disa medime kryesore dhe në ato online, të cilat po përdoren për qëllime biznesore dhe për shantazh politik. Pra, këtu kërkojmë vëmendjen e Kuvendit dhe të qeverisë që të marrin masa dhe të kuptojmë më shumë se çfarë po ndodh me funksionimin e medieve, transparencën si dhe me identifikimin e pronësisë së medimeve", ka thënë Pacolli në Kuvendin e Kosovës derisa ka folur për raportin e Parlamentit Evropian për Kosovën.



Hoti: Shqetësuese mungesa e masave nga qeveria lidhur me rritjen e çmimeve



PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se është shqetësuese mungesa e masave nga ana e qeverisë për situatën aktuale me rritjen e çmimeve. Në seancën e Kuvendit të Kosovës të enjten, Hoti ka thënë se propozimi i LDK-së për heqjen e akcizës për kohësisht në naftë dhe përgjysmimi i TVSh-së do të ofronte për qytetarët çmimin e naftës rreth 1.30 euro. "Shqetësuese vërtet është mungesa e çfarëdo mase nga ana e qeverisë, nëse nuk gaboj më 2019, kur inflacioni ka qenë 3.4 për qind. Atëherë, nëse nuk jam gabim, Vetëvendosja e pati shpallur vitin 2019 vit të rritjes së çmimeve, me 3.4 për

qind, tash çmimet kanë shkuar mesatarisht 14 për qind dhe nuk ndërmerret asnjë masë. Shihni pak ekonomitë e tjera çfarë po bëjnë në këtë drejtim", ka thënë ai.

Deputeti i LDK-së ka thënë se e vetmja masë e ndërmarrë nga qeveria është caktimi i çmimit maksimal të naftës. "Propozimi ynë, që heqja e akcizës për kohësisht në naftë dhe, ndoshta, përgjysmimi i TVSh-së, do të kishte funksionuar perfekt me këtë masë të caktimit të çmimit maksimal dhe sot çmimin e naftës ndoshta do ta kishim, pa akcizë dhe me përgjysmë TVSh, me rreth 1.25 ose 1.30 euro për litër të naftës", ka thënë Hoti.

Inspektorati gjobitë tetë furra në Pejë dhe Gjilan, mashtruan për peshën e bukës

PEJË, 14 KORRIK (ER) - Tetë furra të bukës në Pejë dhe Gjilan janë gjobitur nga Inspektorati Qendror i Tregut. Ministria e Tregtisë ka njoftuar se këto gjoba janë shqiptuar pasi tri bizneseve nuk u përputhej pesha e deklaruar e bukës dhe ndaj pesë të tjerave të cilat kishin peshoret e paverifikuara. "Të nderuar

qytetarë, Inspektorati Qendror i Tregut, së bashku me Agjencinë e Metrologjisë dhe inspektorët komunalë të tregut, kanë kryer verifikime të jashtëzakonshme të peshoreve nëpër furrat e bukës dhe, gjithashtu, verifikimin e peshës së bukës. Janë shqiptuar gjoba ndaj tri bizneseve të cilave nuk u

përputhej pesha e deklaruar e bukës si dhe ndaj pesë bizneseve të cilat i kishin peshoret e paverifikuara. Inspektorati Qendror i Tregut do t'i vazhdojë inspektimet në terren me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe eliminimit të praktikave të padrejta tregtare", ka njoftuar Ministria e Tregtisë.



Rihapet Observatori i Prishtinës

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Në kryeqytetin e Kosovës është rihapur Observatori i Prishtinës. Ky observator për herë të parë ishte

themeluar më 1977 dhe kishte qenë funksional deri në vitet '80. Hapja e Observatorit u bë me ndihmën e komunës së

Prishtinës dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK. Observatori apo Kupola Vrojtuese do të jetë e hapur

për qytetarët për kryerjen e vëzhgimeve qiellore dhe kërkimeve shkencore nga Klubi i Astronomëve të Kosovës.

Lulzim Rafuna, kryetar i ri i Odës Ekonomike të Kosovës

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Lulzim Rafuna është zgjedhur kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. Ai ka marrë 27 vota nga anëtarët e Kuvendit dhe mandati i tij do të jetë katërvjeçar.

Në garë për kreun e OEK-it ishte edhe Erëza Vela, e cila ka marrë 11 vota si dhe Ruzhdi Kurtishaj 12 vota. Kryetar i deritanishëm i OEK-ut ishte Berat Rukiqi. Lulzim Rafuna më parë ishte

ish-drejtor i Doganës së Kosovës, ministër në detyrë i Financave dhe këshilltar i ish-ministrit të Financave, Bedri Hamza, dhe kryeministrit shqiptar Edi Rama.




Inspektorati mjekësor ushtarak italian mbështet sektorin e mjekësisë së FSK-së

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Në kuadër të planit dypalësh Itali - Kosovë për vitin 2022, delegacioni nga Ministria e Mbrojtjes e Kosovës, i udhëhequr nga drejtori i Departamentit të Mjekësisë, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj dhe Burim Abazi, zyrtar i Departamentit Ligjor të Ministrisë së Mbrojtjes, morën pjesë në një takim ekspertësh, të mbajtur në Romë, me temë: "Finalizimi i një marrëveshje teknike në fushën e shëndetësisë ushtarake".

Në veçanti, me mbështetjen e dhënë nga Njësia e 4-t Shëndetësore "Bolzano", ekipi pati mundësinë të vizitonte një strukturë "Basic Role2" (strukturë shëndetësore ushtarake), e sapomarrë në dorëzim nga

Komanda Logjistike e Ushtrisë Italiane, duke vlerësuar funksionalitetin e saj dhe aspekte të veçanta. Për më tepër, delegacioni nga Ministria e Mbrojtjes pati bisedime të frytshme me Inspektoratin e Përgjithshëm të Shëndetësisë Ushtarake Italiane ku, falë mbikëqyrjes së Zyrës për Çështjet Ligjore pranë Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes, u bë e mundur të hartohej drafti përfundimtar i marrëveshjes teknike të përmendur "Marrëveshjes teknike në fushën e shëndetësisë ushtarake ITA/KSV".

Ky dokument do të nënshkruhet nga të dyja palët në një ceremoni zyrtare, këtë vjeshtë, dhe do të hyjë në fuqi në vitin e ardhshëm.



Kurti shkruan në librin e zisë për vdekjen e ish-kryeministrit të Japonisë

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Në librin e zisë, të hapur në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, kryeministri Albin Kurti ka shprehur respektin dhe nderimin për ish-kryeministrin e Japonisë, Shinzo Abe, i cili është vrarë ditë më parë. Kryeministri Kurti është pritur në ambasadë nga ambasadori i Japonisë, Akira Mizutani, të cilit i ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta për humbjen e Shinzo Abesë. "Puna e z. Abe për demokracinë, lirinë dhe sigurinë në Japoni dhe në

botë ishte e jashtëzakonshme. Ai ishte një burrë shteti që punoi pa u lodhur për të çuar përpara një vizion të përbashkët për një botë të lirë dhe të hapur", ka shkruar kryeministri Kurti në librin e zisë. Kryeministri e ka vlerësuar kontributin e rëndësishëm të Abesë në marrëdhëniet ndërmjet Japonisë dhe Republikës së Kosovës, si një mik dhe partner i madh i vendit dhe popullit tonë. "Do ta nderojmë me mirënjohje të thellë kujtimin për të", ka shkruar Kurti.

Në Klinikën e Kirurgjisë Torakale për gjashtë muaj u kryen 248 operacione

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Në Klinikën e Kirurgjisë Torakale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, gjatë

periudhës janar-qershor 2022, janë kryer 248 operacione të përgjithshme dhe 91 operacione me anesteziën

lokal. Për gjashtë muaj në këtë klinikë janë bërë edhe 50 bronkoskopi.

Në bazë të raportit të punës gjatë kësaj kohe janë realizuar edhe 228 drenazhe torakale dhe 1 726 vizita ambulatorie.



Një vështrim mbi draftin e dokumentit të strategjisë së energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031



SHKRUAN: DR. SC. FERAT SHALA

Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Ekonomisë, ka përgatitur draftin e dokumentit të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën kohore 2022-2031. Dokumenti aktualisht është në fazën e diskutimit publik. Duke marrë për bazë faktin se Strategjia e Energjisë është një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike, zhvillimore dhe politike të një vendi, në cilësinë e udhëheqësit të Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Kosovës dhe në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Kosovës, kam bërë një analizë të këtij dokumenti dhe përmes këtij shkrimi po prezantoj disa nga mangësitë, dilemat dhe nevojat për përmirësimin e tij.

Pritshmëritë nga Strategjia e Energjisë

Procesin e hartimit të kësaj strategjie në Kosovë e ka karakterizuar një fushatë agresive publike qysh në zanafillën e saj dhe si rezultat i kësaj qasje janë krijuar pritshmëri të jashtëzakonshme të publikut, shoqërisë, institucioneve qendrore e lokale, donatorëve dhe aktorëve të tjerë. Sigurisht që interesimin dhe pritshmëritë nga ky

dokument për publikun dhe grupet e interesit të shoqërisë sonë e ka shtuar edhe kriza energjetike në vend dhe ajo në nivel global e vitit 2021, e cila po vazhdon edhe sot. Pritshmëria e lartë për dokumentin e strategjisë është bërë edhe më e madhe dhe më kurioze duke marrë për bazë faktin se për hartimin e saj është angazhuar që nga fillimi Instituti Ndërkombëtar - REKK, i mbështetur nga konsulenca TETRATEK e financuar nga USAID-i.

Të gjitha këto rrethana kanë krijuar ambientin për të rritur pritshmëritë, se do ta kemi një dokument të një cilësie të lartë dhe të krahasueshëm me dokumentet strategjike që hartohen jo vetëm në rajon por edhe në vendet anëtare të BE-së.

Kur kësaj i shtojmë edhe faktin dhe fushatën agresive promovionale që ka bërë Qeveria e Kosovës përgjatë procesit të hartimit të dokumentit, domosdo që edhe pritshmëria duket e arsyeshme dhe reale. Megjithatë, ajo që kemi marrë nga e gjithë kjo pritje, përmes draftit të dokumentit të prezantuar në debat publik, lë shumë për të dëshiruar, ngase cilësia e tij është larg pritshmërive reale.

Roli i Kuvendit të Kosovës dhe aktorëve të tjerë në këtë proces?

Sidoqoftë, duke qenë se Kuvendi i Republikës së Kosovës është autoriteti final që i hap rrugë implementimit të Strategjisë së Energjisë, dhe për shkak të rëndësisë vitale për ekonominë, jetën shoqërore por edhe interesin e përgjithshëm të vendit që ka sektori i energjisë, kam besimin që deputetët e kuvendit pavarësisht nga përcaktimet dhe grupimet politike aktuale, do të japin kontributin e tyre në përmirësimin e dokumentit apo kthimin e tij për rishqyrtim.

Aq me tepër nevoja që të kemi një dokument të mirëfilltë për sektorin e energjisë shtohet edhe më nëse marrin për bazë rrethanat e krizës botërore energjetike, në njërin anë dhe përkushtimit e madh të BE-së për të mbështetur Ballkanin Perëndimor, në të gjitha dimensionet e sektorit të energjisë dhe jo vetëm, përfshirë edhe me një plan financimi si kurrë më parë në histori.

Gjithashtu edhe rrethanat aktuale në nivelin nacional, shtojnë nevojën dhe kërkojnë angazhim e të gjitha grupeve të

interesit duke përfshirë edhe Qeverinë e Kosovës, që të punojnë me një qasje bashkëpunuese proaktive me objektiv për t'i shtuar vlerë të mëtejshme dokumentit mbi bazën e rolit të Kuvendit sipas përgjegjësive që i jep Ligji i energjisë.

Ajo që duhet të kenë parasysh të gjithë është se, nuk guxojmë që të sakrifikojmë cilësinë e dokumentit për shkak të afateve kohore të miratimit të saj.

Andaj, apelohej që kritika të kuptohet si instrument i nevojshëm dhe i duhur për përmirësimin e dokumentit për aq sa është i nevojshëm dhe i mundur, në mënyrë që institucionet shtetërore dhe të gjitha ata që kanë detyrime të zbatimit të kësaj Strategjie të kenë një referencë të qartë që do të burojë nga miratimi i saj në Kuvend.

Meqenëse deputetët e Kuvendit janë ata që me votën e tyre në fund i hapin rrugën implementimit të strategjisë, kjo nënkupton se ky institucion merr përsipër autorësinë e versionit final të miratuar prej tij. Ky fakt është i mjaftueshëm për të nxitur bashkimin e potencialit për të dhënë kontributin e përbashkët cilësor brenda kapaciteteve të parlamentit duke kërkuar edhe mbështetje

profesionale që i lejojnë procedurat.

Kostoja e lartë, sfida kryesore e implementimit

Një nga sfidat kryesore të implementimit të strategjisë është edhe kostoja e saj. Kostoja e implementimit të kësaj strategjie, është përlogaritur afërsisht 3.6 miliardë euro apo mesatarisht 360 milion euro në vit. Vënia në qarkullim e gjithë këtij buxheti, kthimi i një pjesë të madhe e të cilave bien direkt mbi barrën e konsumatorit të energjisë, kërkon një dizajn politikash sa më eficientë në njërin anë dhe sa më gjeneruese në zinxhirin ekonomik në anën tjetër. Për të gjitha investimet në gjenerim dhe rrjete pavarësisht se a sigurohen nga sektori publik apo privat, barra e kthimit të tyre do të bie mbi konsumatorin me përjashtim të pjesës që vjen prej granteve.

Prandaj identifikimi dhe përcaktimi i politikave implementuese duhet të jenë të fokusuara në ato që gjenerojnë më shumë punësim.

Po ashtu, këto politika dhe masa duhet të jenë sa më kompatible me politikën e BE-së dhe donatorëve në mënyrë që të jemi sa më konkurrentë për qasje në fondet e shumta ndërkombëtare

të planifikuara për Ballkanin Perëndimor në mënyrë që barra e kostove të reformës së sektorit të energjisë të jetë sa më e lehtësuar për konsumatorët dhe taksapaguesit.

Informacionet mbështetëse, analizat dhe studimet e nevojshme për strategjinë

Një nga mungesat kryesore që vërehet lehtë, nga një lexim i thjeshtë, është mungesa e një baze të mjaftueshme të informacionit mbështetës për përcaktimin e objektivave dhe masave për arritjen e tyre.

Ka pak referenca në dokumente të analizave, hulumtimeve dhe studimeve përkatëse. Kjo dukuri nuk është vetëm në këtë dokument por edhe në shumë të tjera dhe nuk është vetëm e kësaj qeverie por edhe në të kaluarën dokumentet nuk e kanë pasur një bazë të qëndrueshme informacioni të besueshëm.

Kjo, është një çështje që duhet mbajtur shënim në mënyrë që në të ardhmen të përmirësohet procesi i hartimit të dokumenteve strategjike, dhe domosdo ka nevojë për një reformë edhe në këtë drejtim. Me një fjalë planifikimet e hartimit të strategjive duhet të përfshijnë sigurimin e analizave, hulumtimeve dhe studimeve qartësisht të dedikuara procesit të hartimit të strategjive dhe vetëm pas kësaj të filloj hartimi i dokumenteve të tilla.

Duket sikur hartuesi i strategjisë së pari ka vendosur një cak të pjesëmarrjes së BRE-ve në sistemin e energjisë elektrike e më pas ka kalkuluar kapacitetin e nevojshëm për arritjen e atij caku. Ndërkaq nuk ofrohet informacion se cili do të jetë çmimi i energjisë elektrike që do të paguaj konsumatori në faturore e të cilit mblihdhen e gjithë kostoja për arritjen e caktuar. Për integrimin e BRE-ve variabile (erë dhe diell), në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes duhen bërë investime të mëdha për t'iu përshtatur nevojës së integritetit të tërë kësaj energjie duke pasur parasysh kufizimet e mëdha që ka sistemi jonë aktual energjetik dhe burimet natyrore të kufizuara fleksibile. Pavarësisht se rol pozitiv do të ketë hapja edhe më e madhe e tregut dhe integrimin i tij siç është përcaktuar në këtë strategji. Me gjithë hapjen më të madhe dhe forcimin e integritetit të tregut, duke qenë se kriza energjetike tashmë ka krijuar një situatë të re edhe në tregun rajonal që është i lidhur edhe me tregun evropian.

Dhe një sasi shumë e madhe që ka ardhur nga tregu i Rusisë do të zvogëlohet t në mënyrë drastike vitet në vijim, nuk është e pritshme që të ketë kthim të shpejtë e aq më pak në nivelin e para vitit 2021 të çmimave të energjisë në rajon.

U tha edhe më sipër se dokumenti i mungon informata qenësore e bazuar në ndonjë vlerësim sa do të përafërt që të

jetë se sa do të duhet të paguaj në muaj për një KWh konsumatori i energjisë elektrike.

Kjo do të krijonte një bazë më të mirë edhe për definimin e politikave sociale përkatësisht ndikimin e politikave të energjisë në to dhe marrjen e masave të përshtatshme nga qeveria për të zbatuar reformën e energjisë pa shkakuar dëme në ekonomi dhe aspektin social.

Politikat strategjike për gazin natyror

Një fakt tjetër që bie në sy është se si hartuesi i Strategjisë ka bërë një lojë fjalësh për të mos thënë asgjë sa i përket masave dhe politikave për gazin natyror.

Shihet qartë se nuk ka pasur një qasje strategjike rreth kësaj çështje, por mjaftohet me një informacion të zhvillimeve të planifikuara që lidhen me studimet në zhvillim e sipër dhe për disa aktivitete të kohëve të fundit që po zhvillohen në nivelin rajonal. Po ashtu libhen anash, studimet e thelluara nga EBRD (Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rekonstruktim) dhe disa të tjera që kohëve të fundit po nga donatorët kredibil po zhvillohen studimet për gazin natyror që janë në një fazë shumë të avancuar, që do të përbënin një bazë të qëndrueshme për të formuluar një politikë strategjike afatgjatë për gazin natyror përfshirë disa hapa strategjik që do të duhej të ishin pjesë e dokumentit. Kjo strategji kështu si është e definuar i thotë Qeverisë të merr vendim për gazin natyror pasi të përfundojnë studimet ndërkohë që dokumenti i Strategjisë është ai i cili duhet përcaktoj politikat strategjike dhe veprimet kryesore të cilat duhet të zbatohen organet ekzekutive, sikurse është përcaktuar edhe në Ligjin për energji (neni 6 paragrafi 5).

Këtu duhet shtuar faktin se dy projekte të Gazit Natyror aktualisht janë ende në fuqi në Listën Prioritare të Komunitetit të Energjisë (ALKOGAP dhe gazsjellësi Maqedoni i Veriut-Kosovë) Mënyra se si është formuluar teksti dhe konteksti lidhur me gazin natyror të krijon përshtypje sikur qëllimisht është bërë konfuze dhe nuk saktëson qartësisht pozicionin strategjik. Strategjia nuk jep orientim të qartë për gazin në kohën kur edhe Kosovës po i afrohen më shumë se kurrë mundësitë që të bëhet pjesë e rrjetit rajonal të gazit natyror, dhe kur gjithashtu edhe vendet që kanë diversifikim të madh të burimeve po ngarendin që të përfitojnë për të qenë pjesë e nismave dhe projekteve rajonale për të shtuar kapacitetet e rrjetave të tyre të gazit natyror dhe diversifikuar ato.

Pra, ajo që kërkohet në lidhje me gazin natyror në Strategjinë e Energjisë, është një riformulim dhe qartësim i politikës strategjike për gazin natyror. Analizat do të duhej të marrin parasysh efektet e gazit natyror në reduktimin e kërkesës për

energji elektrike sidomos me përdorimin e gazit natyror në ngrohje qendrore dhe në industri në zona të afërta me linjën e gazit. Nëse gazi natyror në analiza nuk është marre parasysh edhe nga këndvështrimi i ndikimit në uljen e kërkesës për energji elektrike atëherë është bërë gabim që duhet gjetur mënyrën e përmirësimit dhe reflektimin përkatës në këtë dokument.

Mungesa e planifikimeve për sistemet e ngrohjes qendrore dhe paqartësitë për rehabilitimin e sistemeve ekzistuese

Edhe për sa i përket zhvillimit të ngrohjeve qendrore në qytetet e mëdha të urbanizuara që aktualisht janë pa sisteme të ngrohjeve qendrore, kjo strategji nuk adreson politika strategjike por ofron përshkrim të procesit të hartimit të studimeve. Strategjia është më e qartë vetëm sa i përket zgjerimit të kapaciteteve ekzistuese, por jo edhe për zhvillimin e kapaciteteve të reja. Kur është në pyetje guximi në përcaktimin e politikave strategjike vërehet një anomali logjike në këtë strategji që procesin e mëtejshëm duhet adresohet. Strategjia guxon që të bëjë parashikime dhe planifikime strategjike për Rehabilitimin e TC Kosova A dhe për përcaktimin e trageteve për BRE dhe EE edhe pse nuk ka studime fizibiliteti, ndërsa nuk e bënë një gjë të tillë për gazin natyror edhe pse ka studime të tilla.

Ka paqartësi gjithashtu edhe rreth përzgjedhjes së rehabilitimit të një bllokut/queve të njësisë TC Kosova A. Nga të gjithë këto, është e kuptueshme se rrethanat e sigurisë së furnizimit me energji elektrike në Kosovë janë tejet të vështira.

Marrja e masave të përshtatshme afatshkurta deri në afatmesme, për të siguruar furnizim me energji elektrike janë shumë të kufizuara, sfiduese dhe hartuesi i strategjisë e ka pasur shumë të vështirë për të ofruar zgjidhje afatmesme deri afatgjatë të përshtatshme për të siguruar të paktën energjinë bazë të besueshme.

Të vetmet alternativa që do të mund të merreshin për bazë në analiza krahasuese të opsioneve do të mund të ishin:

- ◆ Të rehabilitohen kapacitetet ekzistuese gjeneruese nga thëngjilli;
 - ◆ Të mbyllen kapacitetet që e kanë kaluar jetëgjatësinë dhe të importohet energjia e munguar;
 - ◆ Të ndërtohen kapacitete të reja me thëngjill apo me gaz natyror;
 - ◆ Të ulet në mënyrë drastike dhe shumë shpejt kërkesa për energji elektrike deri në masën e energjisë së munguar në rast të aplikimit të masës për mbylljen e TC Kosova A.
- Përderisa rehabilitimi i blloqeve përbën një nga politikat strategjike qendrore të Strategjisë,

nuk ka një përshkrim të qartë se në çka konsiston ky rehabilitim? A është vetëm kaldaja apo të gjitha komponentët e sistemit të gjenerimit prej trajtimit të thëngjillit dhe deri te transformatori?

Cili model rehabilitimi do të aplikohet? Riparim i komponentëve bazë të sistemit të prodhimit, zëvendësim i tyre me të reja, modernizim apo eko-modernizimi?

Cilët shembuj të teknologjive të ngjashme janë marrë në parasysh?, dhe pikëpyetje tjera të ngjashme.

Mbi të gjitha, ka nevojë të elaborohet jo në detaje, por deri në një masë se si një teknologji e viteve 60-ta mund të revitalizohet deri në atë masë sa të arrijë parametrat e operimit në përputhje me kërkesat e BE-së? Gjithashtu nuk ka referenca, studime dhe analiza krahasuese as për aspektet e kostos mjedisore?!

Këto informacione shpjeguese dhe referencat konkrete të analizave dhe studimeve duhet të jenë pjesë e kësaj strategjie.

Bazuar në këto mangësi, hartuesi i strategjisë do të duhej që të paktën të parashihte rrezikun që lidhet me të panjohurat dhe pasiguritë e shumta që ka një politikë e tillë e sigurimit të furnizimit me energji elektrike. Strategjia do të duhej të ofronte një plan alternativ në rast dështimi të realizimit të projektit brenda një afati të caktuar kohor, në mënyrë që të filloj menjëherë aplikimi i planit B strategjik.

Kur kësaj i shtojmë faktin se TC-ja e rehabilituar do të përdoret vetëm si rezervë strategjike, atëherë cila është leverdia ekonomike që të rehabilitohet deri në shkallën e parametrave mjedisore, sikur të një termocentrali të ri, një termocentral që do të punojë në regjimin e plotë vetëm 4 vite dhe me pas në një regjim të përkohshëm vetëm tre muaj në vit?!

Modeli i operimit në statusin e rezervës strategjike (vetëm tre muaj në vit dhe eventualisht në rrethana krizash energjetike sikur kjo e fundit) që po synohet të aplikohet për herë të parë në historinë e zhvillimit të sektorin elektroenergjetik, duke qenë i panjohur.

Kjo gjë strategjisë do të duhej t'i jepte më shumë shpjegim për mënyrën e menaxhimit dhe kostove të mirëmbajtjes kur qëndron në "stand by" dhe të informonte se a janë marrë në konsideratë në analizat e këtyre kostove me rastin e analizës së skenarëve?

Për shkak të rëndësia strategjike të dokumentit është dashur që në procesin analitik mos bëhen përjashtime të opsioneve siç është ai i një centrali të ri me thëngjill i cili do të operonte të paktën deri me 2045, në kushte mjedisore kompatible me kërkesat më të larta të BE-së (BAT - Teknologjia më e Mirë në Dispozicion).

Po ashtu, strategjia nuk jep informacion se a është konsideruar skenari i gjenerimit të energjisë termike (e mbase si

kombinim me elektrike për gjenerimin e energjisë së ngrohjes) për sistemet e termofikimit në komunat e mëdha që do të ndikonte shumë në uljen e kërkesës për energji dhe nevojën për centrale të reja elektrike.

Modernizimi i sistemit dhe burimet njerëzore

Modernizimi i sistemit të shpërndarjes është fokusuar kryesisht në uljen e humbjeve teknike dhe komerciale ndërkohë që strategjia mbështetë një politikë mjaft agresive të rritjes së pjesëmarrjes së BRE-ve, që ka ndikim të jashtëzakonshëm në rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit.

Nevojat për përshtatjen e tyre ndaj kësaj sfide janë të mëdha dhe të kushtueshme që kërkojnë një mobilizim shumëdimensional por që nuk janë shpjeguar nga këndvështrimi konkret i sistemeve të shpërndarjes dhe transmetimit por janë paraqitur në forme të përgjithshme.

Përveç kostove të mëdha të investimeve për përshtatjen e rrjeteve dhe sistemeve, ato kërkojnë edhe investime për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Kjo gjë kërkon kohën e vet, prandaj do të duhej të zinte vend strategji si një referencë për procesin e mëtejshëm të implementimit, duke qenë se politikat që kanë efekte të mëdha në kostot e sistemeve duhet të përcaktohen në dokument dhe më pas të shërbejnë si bazë për operatorët dhe rregullatorin për caktimin e tarifave që lidhen me kostot. Ky element i qenësishëm i dokumentit përbën arsyen kryesore që Strategjia e Energjisë duhet të miratohet në Kuvend dhe se çdo devijim në projektet e rëndësishme duhet të miratohet në Kuvend sepse prek direkt konsumatorin në tarifa të energjisë.

Masat për nxitjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë

Për sa i përket politikave dhe masave të nxitjes së burimeve të ripërtërishme të energjisë, politika është më e qartë në përcaktimin e kapaciteteve prodhuese të erës dhe diellit në shkallë të madhe ndërsa ka pak informacion për gjenerimin nga konsumatorët vet-prodhues, për natyrën e politikave nxitëse, masave dhe grupet e synuara të përfitimit nga këto politika.

Si është përcaktuar targeti së paku 100 MW për konsumatorët vet prodhues?

Nuk shihet ndonjë referencë për analizën se si është bërë një ndarje e tillë e kapaciteteve të prodhimit të energjisë nga gjenerator fotovoltatik nga investitorët (600 MW energji nga

gjeneratorët fotovoltaik) dhe nga konsumatorët vet prodhues (së paku 100 MW). Nuk duket të jetë bërë ndonjë studim apo vlerësim analitik për të përcaktuar leverdinë ekonomike për ekonominë e vendit dhe për konsumatorët.

Është e domosdoshme të shihet se sa leverdi ekonomike ka nga 600 MW nga gjeneratori fotovoltaik dhe sa nga 100 MW nga konsumatorët e shpërndarë vet prodhues.

Cilat janë përfitimet shumëdimensionale të së parës ndaj të dytës?

Është e logjikshme të besohet se përveç kostove më të mëdha që ka përshtatja e sistemit të shpërndarjes për menaxhimin e rrjedhave të energjisë nga konsumatorët vet prodhues, për aspektet tjera siç janë ato ekonomike e sociale.

Investimi në mbështetjen e gjenerimit nga konsumatorët vet prodhues është shumë më i leverdishëm duke qenë se ulë kërkesën për energji elektrike, ulë kostot e energjisë që merr nga rrjeti dhe me këtë bizneset bëhen më konkurrues, rritë punësimin në sektorin e shërbimeve, rritë kapacitetet e konsumatorëve për të vepruar si tregtar, dinamizon tregun e energjisë etj.

Prandaj duke qenë një nga politikat më sensitive pa cenuar cakun që përcaktohet në këtë strategji, duhet të rishikohet seriozisht shkalla e mbështetjes së konsumatorëve vet prodhues në totalin e kapacitetit të targetuar.

Të paktën, kjo strategji duhet të mundësojë që të mbështeten konsumatorët e vet prodhues në një shkallë deri 300 MW deri në 2031 duke përfshirë sektorin e amvisërisë, komercial, shërbimeve dhe të industrisë.

Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet modernizimit dhe digitalizimit të sistemit të

shpërndarjes dhe kjo është një sfidë që duhet evidentuar por me synim që në periudhë pas 2025 t'i jepet hov. Strategjia duhet të përcaktoj edhe politikat nxitëse të BRE-ve edhe në sektorët tjerë ekonomik dhe jo vetëm në sektorin e energjisë sepse përgjegjës për përcaktimin e politikave të sektorit të energjisë është vetëm ministria përgjegjëse për energji. Në rastin konkret kjo strategji duhet të përcaktoj politikat e BRE-ve në transport, në mjedis që lidhet me mbeturinat dhe në bujqësi e pylltari.

Dekarbonizimi dhe eficientia e energjisë

Kur hartuesi i Strategjisë ka përcaktuar dekarbonizimin si një nga boshtet rreth të cilit shtjellohen politikat dhe masat e Strategjisë së Energjisë, eficientia e energjisë do të duhej adresonte politika të qarta e të mbështetura në analiza dhe studime të besueshme dhe t'iu adresohet atyre.

Përveç caqeve të maksimale të konsumit të energjisë, kursimeve dhe rritjes se kapaciteteve të rrjetave ekzistuese të sistemeve të ngrohjes qendrore pothuaj se është e thatë dhe e papërshtatshme për të orientuar implementuesit e saj për të përcaktuar aktivitete dhe projekte të mirë-objektivizuara.

Përveç kësaj strategjia është fokusuar vetëm në sektorin e banimit dhe në atë të ngrohjes qendrore, ndërkohë që sipas legjislacionit në fuqi, mandati për përcaktimin e politikave të eficientës së energjisë në të gjithë resorët i përket ministrisë përgjegjëse për energji. Është e vërtetë se në sektorin e banimit ka shumë potencial për reduktimin e kërkesës për energji dhe duhet të ketë një fokus më të madh, mirëpo edhe në të gjithë sektorët tjerë siç janë industria dhe transporti ka potencial kursimi

dhe njëdhimisht edhe reduktim të emisioneve të larta. Andaj kjo strategji është dashur të vendos targete por edhe politika dhe masa adekuate për të shërbyer si referencë në hartimin e dokumenteve dhe planeve implementuese.

Inovacioni si alternativë dhe thëngjilli si burim energjetik

Arsimi, shkenca, hulumtimi dhe inovacioni janë adresuar jo mjaftueshëm. Përveç në të gjitha dimensionet e kësaj strategjie hulumtimi dhe inovacioni do të duhej të zinte vend të veçantë shfrytëzimi i thëngjillit përmes teknologjive të pastra. Kjo mund të adresohet përmes një Programi Nacional të nxitjes së hulumtimit dhe inovacionit në fushën e energjisë. Politika strategjike për minierën e thëngjillit mungon pavarësisht se adresohet në Strategjinë e Minierave. Thëngjilli si burim energjetik do të duhej të zinte vend në këtë dokument pavarësisht se Ligji për energjinë nuk e trajton thëngjillin por ligji për miniera. Së paku strategjia do të duhet të adresoj çështjen e trajtimit të thëngjillit si një sektor ekonomik industrial për prodhimin e produkteve të ndryshme, apo edhe ndoshta edhe do të kërkonte që të kishte një ligj të veçantë për thëngjillin.

Aspektet mjedisore

Edhe pse sipas Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), planet dhe programet për sektorin e energjisë do të duhet t'i nënshtrohen këtij vlerësimi, kjo nuk ka ndodhur me Strategjinë e Energjisë. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për planet dhe programet realizohet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis. VSM-ja është një mjet i

rëndësishëm procedural për vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore dhe shëndetësore të planeve, politikave, programeve dhe dokumenteve të tjera strategjike, siç janë politikat kombëtare të energjisë. Rezultatet e VSM-së përdoren për të këshilluar planifikuesit, vendimmarrësit dhe palët e interesuara për çështjet e mundshme mjedisore që lidhen me propozimet strategjike.

Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinorë dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, - të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.

Pyetje dhe dilema?

Përveç çështjeve të prezantuara më lartë në dokument mbeten edhe shumë pyetje dhe dilema që do të duhej të kishin një përgjigjeje konkrete.

Disa nga më të rëndësishmet janë edhe këto si në vijim:

♦ A mund të ketë Kosova një sektor energjetik pa CO2 deri në vitin 2050, të integruar në tregun Pan-Evropian, dhe që garanton siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përballeshmëri për qytetarët?

♦ Sa do të jete pjesëmarrja e energjisë së gjeneruar në vitin 2050 dhe cilat burime energjetike

do të dominojnë?

♦ A është e mundur zhvillimi i kapaciteteve të reja të BRE-ve të erës dhe fotovoltaike, për të arritur një kapacitet të përgjithshëm të instaluar të BRE-ve prej së paku 1400 MW deri në 2031?

♦ Sa është eficientia respektivisht shkalla e shfrytëzimit e paneleve fotovoltaike dhe gjeneratorëve të erës?

♦ Sa planifikohet të ketë gjenerim nga BRE, kur dihet shkalla e ulët e eficientës së burimeve të tillë?

♦ A ka ndonjë studim mjedisor se çfarë do të ndodhë me bateritë pas 5-7 viteve, dhe se çfarë do të ndodhë me panelet fotovoltaike pas 20-25?

♦ Për promovimin e cilave sistemeve të kogjenerimit eficient dhe ngrohjes qendrore eficiente, flet strategjia dhe nëse do të kemi dekarbonizim total deri në vitin 2050, çfarë sistemi i kogjenerimit do të përdoret?

♦ A është e mundur arritja e kursimit kumulativ të energjisë prej 283 ktoe në ndërtesa, përfshirë ndërtesat publike, private dhe komerciale deri në vitin 2031 dhe cili lloj i energjisë planifikohet të kursehet?

♦ Pse në strategji nuk ka asnjë planifikim që do të shqyrtonte mundësitë e shfrytëzimit të energjisë nga hidrogjeni i gjelbër?

♦ Pse nuk ka asnjë propozim apo sugjerim për të shikuar mundësitë e bashkëfinancimit me Shqipërinë në projekte të rëndësishme rajonale?


♦ Pse nuk ka asnjë parashikim për nevojat infrastrukturore dhe energjetike për ndryshimet që duhet behen në përshtatjen me nevojat e automjeteve elektrike?

♦ Pse nuk ka ndonjë planifikim konkret se çka do të ndodhë me transformimin e KEK gjatë procesit të dekarbonizimit?

**Autori është kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuwendit të Kosovës.*



Si i fitojnë paratë gjenitë? Ja çfarë në mëson historia



Nga Jonny TOMSON

Me fat janë ata njerëz që paguhen për të bërë atë që duan. Siç e thotë edhe shprehja “Nëse gjen një punë që e do, nuk do të duhet të punosh asnjë ditë në jetën tënde!”. Por pak njerëz mund të mbijetojnë vetëm nga një punë që e dashurojnë vërtet. Artistët, shkrimtarët, muzikantët, kërcimtarët, aktorët ose koleksionistët anembanë botës dëshirojnë të fitojnë mjaftueshëm nga pasionet e tyre, që të mund ta mbajnë frymën gjallë.

Mjerisht, jeta e ka zakon të kërkojë nga ne atë që nuk duam ta japim. Pra, shumica prej nesh përfundojmë duke punuar në mënyrë që të mund të aktojme. E njëjta gjë vlente dikur për shumë prej artistëve, shkencëtarëve, novatorëve dhe mendimtarëve më të mëdhenj. Gjenitë e historisë duhej të paguanin faturat dhe të ushqenin familjen, po aq sa ne të tjerët.

Sigurisht, shumë nga “njerëzit më të mëdhenj” të të gjitha kohërave patën shumë ndihmë. Ata ishin lordë ose baronesha, trashëgimtarë të pasurive, ose me titujt aristokrat. Por të tjerët kishin një prejardhje shumë më modeste. Ja 4 shembuj se si e fituan jetesën disa nga emrat më të mëdhenj në histori:

Isak Njuton

Njutoni ka qenë një nga njerëzit më të ditur dhe më inteligjentë në histori. Por familja e tij ishte fshatare, dhe babai i tij ishte një burrë i pashkolluar që nuk

mund të shkruante dot as emrin e tij. Kur shkoi në Universitetin e Kembrixhit, ai duhej ta fitonte shkollimin e tij duke qenë shërbëtor i studentëve të tjerë.

Kur një epidemi murtaje i ktheu të gjithë studentët në shtëpi, Njutoni e kaloi kohën duke r e v o l u c i o n a r i z u a r matematikën, optikën, fizikën dhe astronominë. Kur u rikthye në universitet iu dhanë poste të larta akademike. Por në atë kohë këto tituj nuk të dhuronin miliona. Pas vitesh punë të palodhur, presionesh nga mbreti katolik Xhejmsi II (pasi Njutoni ishte protestant) dhe një krize nervore, Njutoni vendosi të hiqte dorë nga të gjitha për t’u bërë i pasur.

Në Londër, ai përdori gjenialitetin e tij në matematikë për t’u bërë krye-bankier i mbretit. Me kursin e sotëm, ai ka të ngjarë të ketë pasur një pagë me 7 shifra. Pra, pavarësisht se shkroi atë që njihet si një nga veprat më të mëdha shkencore të të gjitha kohërave, Njutoni i fitoi paratë e tij kryesisht nga të qenit një bankier i qeverisë mbretërore.

Uilliam Shekspir

Jeta e një aktori është e vështirë. Ajo nënkupton orë të gjata pune, dhe ndonjëherë duhet të angazhohesh në 2 ose 3 shfaqje brenda ditësh. Aktorët e sotëm raportojnë nivele dukshëm më të larta të depresionit, ankthit dhe stresit sesa popullsia mesatare. Por gjërat ishin paksa më ndryshe në Anglinë e shekullit XVII-të.

Edhe pse njihet gjerësisht si shkrimtari, poeti, dramaturgu më i madh në histori, Shekspiri

nuk pati një jetë luksoze me pallate, verëra dhe kuaj të mirë. Babai i Shekspirin, duke kursyer pak nga shitja e leshit në tregun e zi, i dha të riut Uilliam paratë për të blerë aksionet në kompaninë e tij të parë teatrale.

Kompania fitoi mirë, por asnjëherë aq shumë sa për ta bërë të pasur. Shekspiri nuk u pagua asnjëherë si autor i dramave, por nga fitimet e gjithë trupës së aktrimit. Nëse aktorët do të ishin të dobët, apo nëse shfaqja nuk do të vlerësohej, Shekspiri do të ishte në telashe. Për Shekspirin ka shumë pak të dhëna. Por 2 dokumente tregojnë se ai pati 2 herë probleme me mospagimin e taksave. Nuk mund të jemi të sigurt nëse kjo ishte nga dyfytërsia, neglizhenca apo mungesa e parave. Por dimë se në prag të vdekjes, Shekspiri jetonte në një shtëpi të mirë, por jo shumë të madhe. Ai i shiti aksionet e tij në kompaninë teatrale, për të pasur sa më shumë të ardhura të disponueshme.

Mari Kyri

Fituese e Çmimit Nobel në dy fusha të ndryshme, Marie Curie ishte një nga 5 fëmijët e familjes, të cilën i ati e zhyti në mjerim pas një sërë investimesh të tmerrshme. Në moshën 17-vjeçare, Mari bënte 3 punë si mësuese, si lexuese për punëtorët dhe si guvernante, në mënyrë që të mund të financonte jo vetëm arsimin e saj, por edhe të motrës.

Kur shkoi në Universitetin e Sorbonës, në Paris, punonte aq shumë gjatë natës sa shpesh harronte të hante. Aty asaj iu

dhanë grante të ndryshme kërkimore për të studiuar çelikut. Kur bashkëshorti i saj vdiq pasi u godit nga një karrocë, ajo mori përsipër punën e tij, dhe kështu u bë profesoresha e parë grua në Sorbonë.

Por pas fitimit të Çmimit Nobel për fizikë dhe kimi, paratë nuk ishin më një problem për të. Me kursin e sotëm, çmimi i saj i vitit 1903 vlen afërsisht 550.000 dollarë. Dhe ajo fitoi 2 të tillë. Por në vend se t’i shpenzonte për një jetë mondane, Kyri i shpenzoi për krijimin e institucioneve kërkimore. Albert Ajnshtajni mendohet të ketë thënë: “Nga të gjithë njerëzit e famshëm, Kyri është e vetmja që nuk u korruptua nga fama!”.

Rene Dekarti

Nëna e Dekartit vdiq kur ai ishte vetëm 1-vjeç. Babai i filozofit, një politikan i njohur i zonës, ishte shumë i zënë dhe shumë i varfër për t’u kujdesur për Renenë dhe vëllezërit e motrat e tij. Pasi u dërgua për të marrë një arsimim të mirë (por edhe të rreptë) tek Jezuitët, Dekarti lulëzoi si një nga gjenitë e Rilindjes.

Por netët e gjata, leximi nën dritën e qiririt, dhe zhbërja e modelit shkencor aristotelian, bërë që Dekarti të braktiste jetën universitare pas një krize nervore. Gjithsesi me intelektin e jashtëzakonshëm vijnë shumë mundësi. Ai fitoi disa para duke përdorur teorinë e probabilitetit, përpara se t’i bashkohej ushtrisë. Atje projektoi të gjitha llojet e fortifikimeve mbrojtëse, mjetet e rrethimit dhe armët vdekjeprurëse për të ndihmuar punëdhënësin e tij, Princin Moris të Nasaut. Por me gjithë

gjenialitetin e tij në shumë fusha, Dekarti e përfundoi jetën e tij në arrati dhe në mëshirën e cilitdo që do ta pranonte ta punësonte.

Punë me gjysmë kapaciteti

E vërteta e trishtueshme e gjenit, është se ai nuk paguan faturat. Pas çdo mendimtari, zbulimi, shpikjeje apo kryevepre arti, fshihen ose orë shumë të gjata pune të lodhshme ose një trashëgimi dhe pasuri e madhe. Fakt është se gjenit i duhet kohë dhe para për t’u rritur.

Është dëshpëruese të mendosh se sa artistë, shkencëtarë, shkrimtarë apo filozofë kemi humbur, thjesht sepse ishin shumë të zënë me punë për të ushqyer fëmijët e tyre. Sa shpesh është shpërdoruar gjenialiteti duke larë enët apo duke rregulluar shtratin?

Kjo vlen sidomos për gratë. Filozofja angleze Meri Uollstounkraft, tha dikur se nëse shoqëria i detyron gratë të jenë qytetare të klasit të dytë – të mbyllura, të paarsimuar dhe të papunësuar – atëherë përparimi do të ecë vetëm me gjysmën e kapacitetit (vetë ajo ishte me fat pasi vinte nga një familje shumë e pasur).

Nëse u jepni njerëzve më shumë mundësi, atëherë do të merrni më shumë rezultate. Bursat shtetërore, grantet universitare, patronazhi privat dhe subvencionimet e qeverisë, janë të gjitha të nevojshme nëse synohet të lulëzojnë gjenitë. Ne duhet ta bëjmë sa më të lehtë që të jetë e mundur që njerëzit e shkëlqyer të bëjnë gjëra të shkëlqyera.

| “Big Think” – Bota.al



RI SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i punës/Pozita: Auditor i Brendshëm

Departamenti: i Auditimit të Brendshëm (DAB)

I raporton: Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm

Niveli i gradës: 5

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës

Auditori i Brendshëm kryen auditime financiare, të teknologjisë informative, të pajtueshmërisë, auditimin e Menaxhmentit, si dhe hulumtimet paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale në përputhje me standardet për praktikatat profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe bënë vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve.

Auditori i Brendshëm punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Auditimet e Brendshme:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Kryen auditime të brendshme, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në një vijë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raportet, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët e brendshëm, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm dhe Auditorët e Jashtëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e AB-së, Manualin e AB-së, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikatat Profesionale të Auditimit të Brendshëm, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilat rregullohet fushëveprimtaria e auditimit të brendshëm.

Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante) duke propozuar dhe ndikuar në përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm, monitoron performancën, propozon dhe ndikon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transaksionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Drejtorit të DAB-it, apo vetë departamentit.

Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë dëshirë për pjesëmarrje në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të punonjësve në Departamentin e Auditimit të Brendshëm;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Departamentit të Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

Përgatitjet profesionale/kualifikimet

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, kontabilitetit, menaxhmentit, apo juridike;
- Së paku tri (3) vite përvojë në fushën e auditimit të brendshëm, apo të jashtëm;
- Çertifikatë profesionale në fushën e auditimit të brendshëm të sektorit publik/privat;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar (Gjuha angleze e preferueshme);
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 korrik 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



PONOVNO OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta / pozicija: Unutrašnji revizor

Departman: za unutrašnju reviziju (DUR)

Izveštava: Direktor Departmana za unutrašnju reviziju

Nivo stepena: 5

Svrha i delokrug pozicije

Unutrašnji revizor vrši finansijske revizije, usklađenosti, informacione tehnologije, usklađenosti, reviziju Menadžmenta kao i preliminarne istraživanje određenih operativnih i funkcionalnih aktivnosti u skladu sa standardima za profesionalnu praksu unutrašnje revizije, kao i ocenu efikasnosti unutrašnjih kontrola ovih aktivnosti

Unutrašnji revizor radi pod direktnim nadzorom direktora Departmana za unutrašnju reviziju CBK-a.

Delokrug rada za ovu poziciju je sledeći:

- Unutrašnje revizije;
- Sistemi i procedure i druga administrativna pitanja;
- Obuka i razvoj.

Dužnosti i odgovornosti

Unutrašnje revizije:

- U saradnji sa nadzornikom učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za vršenje revizija i drugih relevantnih usluga;
- Vršiti unutrašnje revizije, obavlja intervju sa osobljem, prima i analizira relevantnu dokumentaciju u skladu sa ciljevima CBK-a i u skladu sa Zakonom o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statutom unutrašnje revizije, Priručnikom za unutrašnje revizije, itd.;
- Vršiti redovne revizije ili revizije na zahtev, o efektivnom korišćenju resursa CBK-a, sastavlja nacрте izveštaja, diskutuje o rezultatima sa nadzornikom i unutrašnjim revizorima i sastavlja završne izveštaje o njegovom/njenom angazovanju;
- Aktivno učestvuje u diskusijama sa unutrašnjim revizorima, finalizuje dosije revizije i prati sprovođenje preporuka datih od strane unutrašnje revizije i spoljnih revizora;
- Pruža savete o pitanjima revizije, po potrebi;
- Sprovodi Zakon o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statut UR-a, Priručnik UR-a, Etički kodeks, Međunarodne standarde o profesionalnoj praksi unutrašnje revizije kao i sve druge akte koji regulišu delokrug unutrašnje revizije.

Sistemi/procedure i administrativna pitanja:

- Vršiti nezavisne preglede postojećih ili predloženih sistema u svim entitetima CBK-a (departmanima, odeljenjima i drugim relevantnim oblastima) predlažući i utičući na njihovo poboljšanje;
- Ocenjuje efektivnost i efikasnost svih važnih sistema unutrašnje kontrole, prati učinak, predlaže i utiče na unapređenje funkcionisanja sistema unutrašnje kontrole;
- Testira rad sistema u CBK-u, pouzdanost i potpunost informacija, kao i transakcije generisane u skladu sa zakonima, politikama, procedurama, planovima i uredbama kojima se upravlja CBK;
- Vršiti administrativne poslove prema potrebama direktora DUR-a, ili samog departmana.

Obuka i razvoj:

- Da ima volju da učestvuje u relevantnim obukama za unutrašnje revizije i da pruži odgovarajuću pomoć ostatku osoblja u Departmanu za unutrašnju reviziju;
- Da dokaže da on/ona razvija njegove/njene veštine u korist Centralne banke i Departmana za unutrašnju reviziju, unutar nje.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, računovodstva, menadžmenta ili prava ;
- Najmanje tri (3) godine iskustva u oblasti unutrašnje revizije, ili spoljne;
- Profesionalni sertifikat iz oblasti unutrašnje revizije javnog/privatnog sektora;
- Odlične veštine organizacije, planiranja i upravljanja vremenom;
- Odlične međuljudske i komunikacijske veštine, kao i veštine rešavanja sukoba;
- Tačnost, pažnja na detalje i osetljivost na prioritete;
- Odlično poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika govornog i pisanog (poželjan engleski jezik);
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multietničkom i multikulturnom okruženju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za aplikaciju;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj iz Penzionog fonda koji dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **29. jula 2022. godine**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice : www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**



RI SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i punës/Pozita: Auditor i Lartë

Departamenti: i Auditimit të Brendshëm (DAB)

I raporton: Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm

Niveli i gradës: 4

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës

Auditori i Lartë kryen auditime financiare, të pajtueshmërisë, teknologjisë informative, auditimin e Menaxhmentit, si dhe hulumtimet paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale në përputhje me standardet për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe bën vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve.

Auditori i Lartë punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat, si dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Auditimet e Brendshme:

